



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 326/2 Prot

Tiranë, më 13.11.2020

V E N D I M

Nr.146, datë 13.11.2020

“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit administrativ nr. 72 (1701/4prot.), datë 12.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për largimin nga shërbimi civil të nëpunëses **, për shkak të ristrukturimit të institucionit, Bashkia Tropojë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një informacioni nga një kërkesë e paraqitur prej nëpunësja, *****.

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një kërkesë e protokolluar me nr. 326 prot., datë 18.05.2020, nga nëpunësja *****, në të cilën janë parashtruar pretendimet e saj për shkelje ligjshmërie në procedurën e përfundimit të marrëdhënieve të punës në shërbimin civil nga Bashkia Tropojë, e përmbyllur me aktin administrativ nr. 72 (1701/4prot.), datë 12.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë.

Punonjësja gjithashtu pretendon se, konstatimet e Komisionit të Ristrukturimit në vendimin e tij, nuk janë të sakta dhe nuk justifikojnë lirimimin e saj nga shërbimi civil, pasi ajo pretendon që në institucion, aktualisht, ka vende të lira e për rrjedhojë egziston mundësia për t’u sistemuar në një nga këto pozicione, pasi ka arsimimin e duhur dhe eksperiencën e mjaftueshme në profesion.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm ka filluar verifikimi paraprak i këtij rasti, prej nga ka rezultuar:

Me urdhërin nr. 83 (1585 prot.), datë 15.04.2020, të kryetarit të Bashkisë Tropojë, “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë miratuar, datë 30.12.2019”, janë bërë ndryshime në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të organeve të kësaj bashkie e mbi këtë bazë institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi.

Për kryerjen e këtij procesi, në bazë të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bazuar në urdhrin nr. 103 (1667 prot.) datë 22.04.2020, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit” dhe pikën 17 të Kreut II, të Vendimit nr. 125 datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, për të shqyrtuar mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese ose të ristrukturuara si dhe në rastet e shkurtimeve të vendeve të punës, për të propozuar transferimin e tyre në një pozicion tjetër, të lirë, të së njëjtës kategori, për të cilin ai/ajo plotëson kërkesat specifike. Veprimtaria e këtij komisioni, siç përcaktohet në aktin e sipërpërmendur, bazohet në analizën e përshkrimeve të punës së pozicioneve të ristrukturuara, në ndryshimet e kritereve specifike, si dhe në dosjen personale të nëpunësve në pritje të transferimit, duke evidentuar elementët kyç mbi të cilët do të bazohet vendimmarrja, të tilla si përvoja, arsimi, vlerësimi i arritjeve, etj.

Sipas procesverbalit të mbajtur në datën 29.04.2020 me nr. 1701/2 prot., rezulton se Komisioni i Ristrukturimit, në vijim të procesit për të sistemuar nëpunësit civil të cilëve u është shkurtuar vendi i punës, ka vendosur të propozojë lirimin nga shërbimi civil të punonjësve *****, për shkak të pamundësisë së sistemimit të saj në një nga pozicionet e lira të mbetura apo të ristrukturuara, procedurë e cila është përfunduar me aktin nr. 72 (1701/4prot.), datë 12.05.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjësin me status të nëpunësit civil për shkak të shkurtimeve të vendit të punës si pasojë e ristrukturimit të institucionit Bashkia Tropojë”.

Ankuesja nuk ka qenë dakort me këtë qëndrim dhe për verifikimin e ligjshmërisë së aktit të lirimit ka kërkuar shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ndërkaq, gjatë kryerjes së procesit të verifikimit të këtij rasti, Komisioneri nëpërmjet shkresës me nr. 606/1, datë 21.09.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka rënë në dijeni të faktit se nëpunësja në fjalë i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel, e cila ka filluar shqyrtimin e saj.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me *nr. 326 prot., datë 18.05.2020*, në lidhje me largimin nga shërbimi civil të nëpunëses *****, për shkak të ristrukturimit dhe arkivimit e çështjes, pasi çështja do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Punoi: A.Xhaxhiu, Inspektore e KMSHC

Pranoi: I.Kukumi, Drejtor i Hetimit dhe Inspektimit Administrativ

Miratoi: A. Basha, Drejtore e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes